

# atrc

Qendra e Trajnimeve & Burimeve për Avokim



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

Përkrah komunitetin  
e OJQ-ve



# AVOKUESI

Vëllimi IV • Numri 2 • Mars 2006

## Përmbajtja

### Faqe 2

Qasja në Dokumente Zyrtare Ende e Kufizuar

Rrjeti Rinor i Pejës Nxit Pjesëmarrje më të Madhe të të Rinjve në Shoqërinë Civile

OJQ-të Rajonale Këmbejnë Përvojat në Sllovaki

### Faqe 3

OJQ Çohu Kërkon Logaridhënie nga Ish-Krye parlamentar Nexhat Daci

Kërkesë Propozimesh për Projekte të Rinjsh nga Evropa Juglindore

Institucionet, Shoqëria Civile Diskutoi Lidhjen ndërmjet Pajimit të Taksave dhe Shërbimeve Publike

### Faqe 4

OJQ-të Startojnë Iniciativë Ambienti në Bosnjë

Një Kornizë e Përbashkët, Globale e Organizatave Joprofitabile

## Aktivitetet e ardhshme të ATRC-së

**22 Mars:** Tryezë e rrumbullakët "Sfidat e Opozitës përballë Qeverisë dhe Bisedimeve për Statusin Final" me Z. Hashim Thaçin, kryetar i PDK-së

**4-6 Prill:** Trajnim për Menaxhim të OJQ-ve

**12 Prill:** Trajnim për Ngritje të Fondeve & Marrëdhënie me Donatorë

## ATRC Shpall Shërbimet për Trajtime & Konsulencë për Vitin 2006

Më 9 shkurt, ATRC ka shpallur serinë e parë të punëtorive trajnuese në kuadër të Programit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSP), të titulluar "Hyrje në Avokim dhe Ndërtim Koalicioni".

Punëtoritë është pjesë e një serie të punëtorive trajnuese të planifikuara për vitin 2006, e cila i dedikohet të gjitha OJQ-ve kosovare të regjistruara si klientë të ATRC-së (informatat për regjistrim janë të përfshira më poshtë).

Si organizatë që trajnon dhe përkrah OJQ-të, ATRC-ja gjatë 2006-ës do të ofroj programe trajnimesh dhe konsulenca, të dizajnuara për ballafaqimin e nevojat aktuale dhe në zhvillim e sipër të sektorit të OJQ-ve në Kosovë. Shërbimet e ATRC-së përfshijnë trajnime dhe konsulenca bazike në fushat kryesore të zhvillimit organizativë, menaxhimit të projektit dhe avokim.

Këtë vit ATRC-ja ofron katër



Seancë trajnimiti në ATRC

lloje të shërbimeve për trajnim dhe konsulencë:

*Punëtori  
Konsulencë individuale  
Trajtime sipas kërkesës  
Program të veçantë trajnimiti  
zhvillimor*

Me këto shërbime ATRC-ja synon përbushjen e misionit, gjë që i siguron OJQ-të me njohuri praktike dhe ekspertizë, e cila kontribuon në zhvillimin e potencialit të tyre të plotë dhe u mundëson t'i

arrijnë synimet strategjike në mënyrë të efektshme dhe të qëndrueshme.

Këtë vit, të gjitha shërbimet e ATRC-së janë falas për OJQ-të kosovare të regjistruara si klientë të ATRC-së.

*OJQ-të mund të regjistrohen si klientë në ATRC duke plotësuar formën e regjistrimit, e cila mund të merret online në [www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org), si kurse edhe në zyrë të ATRC-së: Rr. Agim Ramadani, Nr. 15, Prishtinë.*

## Mundësi Financimi për OJQ-të

### Trusti Ballkanik për Demokraci Fokuson Financimin në Kosovë

**G | M | F** ATRC më 2 shkurt ka organizuar takim ndërmjet përfaqësuesve të OJQ-ve dhe Marcel Grogan, zyrtar i programit të Trustit Ballkanik për Demokraci, që është projekt i Fondit Marshall Gjerman me bazë në SHBA. Takimi ka synuar informimin e OJQ-ve lokale për fushat kryesore programore të Trustit Ballkanik dhe mundësitë e financimit.

Grogan u përqendrua në objektivat financuese, prioritetet aktuale dhe procedurat

aplikuese të Trustit Ballkanik, sikurse edhe në fondet në dispozicion për rajonin. "Afrimi i Qytetarëve me Qeverinë," dhe 'Bashkëpunimi Rajonal' janë objektivat e dhënies së granteve," ka konstatuar ai.

Trusti Ballkanik u dhuron grante grupeve qytetare, OJQ-ve lokale, mediave, think tank, qeverive dhe institucioneve arsimore.

Grogan veçoi se këtë vit Trusti Ballkanik është i fokusuar në Kosovë me interesim të veçantë në procesin e decentralizimit

dhe të rinjtë.

Trusti Ballkanik për Demokraci është iniciativë 10 vjeçare dhuruese e granteve, e cila përkrah qeverisjen e mirë në Evropën Juglindore.

Për më shumë informata, ju lutem vizitoni:

[www.gmfus.org/balkantrust](http://www.gmfus.org/balkantrust)

*Prezantime të donatorëve janë pjesë e programit të ATRC-së që synon afrimin e OJQ-ve me mundësi financimi dhe donatorët me OJQ-të, të cilat kanë interesa të ngjashme.*

## OJQ-të Rajonale Këmbejnë Përvojat në Sllovaki

Në janar, tre përfaqësues të OJQ-ve të Kosovës, Rinvest, DokuFest dhe ATRC morën pjesë në një vizitë studimi dhjetëditëshe në Bratislavë, Sllovaki, organizuar nga shoqata me bazë në Sllovaki "People in Peril Association", përkrahur nga Fodacioni për Shoqëri të Hapur. Vizita synonte që përfaqësues të OJQ-ve boshnjake, serbe dhe kosovare të këmbejnë përvojat e tyre dhe të mësojnë nga OJQ-të sllovaqe punën e mira të tyre gjatë procesit të anëtarësimit në BE.

Gjatë vizitës, pjesëmarrësit takuan një grup prej 25 OJQ-ve, përfshirë fondacione, think tank, dhe organizatat të cilat merren me antikorrupsion dhe integritet në BE.

Sllovakia ka një shoqëri të zhvilluar civile e cila ruajtë rol kyç në rrëzimit e ish qeverisë neo-autoritare të Vladimir Meciarit, gjë që përfundimisht çoi në vendosjen e vlerave demokratike në Sllovaki dhe integritet në BE. Organizatat pjesëmarrëse të Ballkanit Perëndimor mësuar për shumë çështje nga homologët e tyre në Sllovaki, përfshirë qëndrueshmërinë financiare të OJQ-ve.

Edhe pse OJQ-të e Ballkanit Perëndimor, përfshirë ato të Kosovës, aktualisht financiarisht përkrahen nga burime të jashtme, sllovakët theksuan se kjo nuk do të zgjas përgjithmonë. Në Sllovaki, disa OJQ mbijetuan pas tërheqjes së donatorëve të huaj.

Financimi i brendshëm ishte kyç. Duke pasur parasysh se Kosova mund të ndodhet në situatë të ngjashme, OJQ-të duhet të fillojnë të shqyrtojnë mundësi të tjera të përkrahjes financiare, siç është financimi i brendshëm, veçuan OJQ-të Sllovaqe.

## Tryezë e rumbullakët e ATRC-së dhe IREX/PKAM

### Qasja në Dokumente Zyrtare Ende e Kufizuar

ATRC dhe IREX/ Programi Kosovar për Asistencë të Mediave organizoi tryezë të rumbullakët më 7 shkurt në zyrat e ATRC-së, ku qeveritarë, përfaqësues të OJQ-ve dhe mediave u mbledhën të diskutojnë çështje që kanë të bëjnë me implementimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare.

Kushtrim Shaipi nga Instituti Kosovar për Hulumtime dhe Dokumentim (KODI) moderoi këtë tryezë, e cila filloi me debat lidhur me zhvillimin e mekanizmave për implementimin e Ligjit. Edhe pse tri vjet kanë kaluar që nga miratimi i Ligjit nga Kuvendi i Kosovës, aplikimi i tij po vonon.

Panelistët e takimit ishin Besim Kajtazi - Ministria e Shërbimeve Publike, Jusuf Osmani - Arkivi Kombëtar, Berat Buzhala - Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë të Kosovës, dhe Naim Krasniqi - Zyra e Ombudspersonit, rajoni i Mitrovicës.

Besim Kajtazi shpjegoi për ndryshimet e bëra në draft Urdhrin Administrativ për implementimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare, pas pranimit të komenteve nga organizatat dhe institucione të tjera.

IREX/USAID, Zyra e Ombudspersonit, Komisioni i Pavarur i Mediave, OSBE-ja dhe Arkivi Kombëtar i kanë dërguar komentet e tyre në Ministrinë e Shërbimeve Publike pas një debati publik të organizuar nga kjo ministri më 8 dhjetor për të diskutuar draft Urdhrin Administrativ.

"Komentet që i kemi marrë kanë ndihmuar shumë në qartësimin e draft Urdhrin Administrativ të Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare", ka deklaruar Kajtazi.

Me gjithë përmirësimin e draft Urdhrin Administrativ, përfaqësuesit e mediave dhe OJQ-ve shprehën shqetësimin e tyre për kompetencat që ky ligj i jep ins-

titucionit publik për dokumentet e klasifikuara si të ndjeshme.

Rrethanat aktuale në Ko-



Të pranishmit debatuan qasjen në dokumente zyrtare

sovë ndalojnë qasjen e gazetarëve në informata, theksoi Berat Buzhala nga Asociacioni i Gazetarëve Profesionist.

Shumica e pjesëmarrësve veçuan se edhe pse ligji është miratuar, implementimi i tij është i kufizuar.

## Rrjeti Rinor i Pejës Nxit Pjesëmarrje më të Madhe të të Rinjve në Shoqërinë Civile

Në mbarë botën, të rinjtë angazhohen në shtyrjen e proceseve përpara. Në Kosovë, Rrjeti Rinor i Pejës (RrRP), i cili përfaqëson shtatë OJQ të të rinjve dhe Qendra Rinore të komunës së Pejës, bashkërisht promovon idetë dhe projektet e grupeve rinore për t'u shërbyer më mirë nevojave të komuniteteve të tyre.

Si rrjet multietnik, këto grupe inicuan fushata promovuese për ta informuar publikun e Pejës për zhvillimet e rëndësishme lokale dhe kombëtare. Për shembull, në vitin 2005 këto grupe u angazhuan në ngritjen e vetëdijes për Standardet për Kosovën. RrRP gjithashtu trajnon të rinjtë, ngrit kapacitetet e tyre në lëmi të caktuara, si

avokim, dialog ndëretnik, të drejtat e njeriut, menaxhimi i konflikteve, planifikim strategjik dhe menaxhim të OJQ-ve.

"Ky rrjet ka mundur që bashkërisht shqiptarë, serbë, boshnjakë, egjiptianë dhe romë, të marrin pjesë në trajnime të ndryshme brenda dhe jashtë Kosovës", ka pohuar koordinatori dhe RrRP, Vlora Latifi.

Që nga themelimi më 2002, RrRP ka zhvilluar shumë aktivitete për pajtim, siç është projekti "Iniciativa Rinore për Pajtim 2004", i cili u përqendrua në fushata publike për ngritje të vetëdijes, promovim të dialogut ndëretnik, dialogun ndëretnik, avokim dhe iniciativat për paj-

tim të të rinjve.

Sipas Latifit, një ndër problemet kryesore me të cilin RrRP ballafaqohet është mungesa e vullnetit në mesin e rinjve të komunitetit serb për t'u përfshirë në aktivitetet e rrjetit.

Ajo u bën thirrje të rinjve të të gjitha rajoneve dhe komuniteteve në Kosovë që të jenë më aktiv dhe të vullnetshëm që të inkadrohen më shumë në organizata joqeveritare.

Asambleja e RrRP çdo gjashtë muaj përcakton prioritetet dhe zgjedh bordin ekzekutiv shtatë-anëtarësh të rrjetit. RrRP po ashtu përkrah punën e rrjeteve rinore në tri qytete të tjera: Klinë, Deçan dhe Istog.

**Tryezë e "Forumit 2015"****Institucionet, Shoqëria Civile Diskutoi Lidhjen ndërmjet Pajimit të Taksave dhe Shërbimeve Publike**

"Forumi 2015" organizoi tryezë të rumbullakët më 19 janar në Hotelin Grand, Prishtinë, për të diskutuar konkludimet e hulumtimit të fundit të Institutit Riinvest, të quajtur "Kultura Fiskale dhe Qëndrueshmëria Buxhetore"

Tryeza inicoi debat lidhur me atë se si kultura fiskale ndikon në qëndrueshmërinë e buxhetit, zhvillimin e përgjithshëm dhe përmirësimin e kualitetit të shërbimeve publike. "Kultura fiskale" mund të definohet si proces në të cilin komuniteti merr pjesë në vendimet për mbledhjen dhe shpenzimin e të ardhurave vjetore publike (taksave).

Shumica e qytetarëve të intervistuar nga Riinvesti kishin qëndrim kritik ndaj menaxhimit dhe shpenzimit të buxhetit. Ata besojnë se shërbime më të mira publike do të nxisnin më shumë njerëz për të paguar taksat.

Sidoqoftë, Ministri i Ekonomisë dhe Financave Haki Shatri theksoi se edhe qytetarët kanë përgjegjësi. "Qytetarët e Kosovës nuk janë në djepi për rëndësinë e pagimit të taksave në mënyrë që të kenë sistem buxhetor të qëndrueshëm dhe efikas," ka thënë ai.

Pjesëmarrës të shoqërisë civile veçuan se pagimi i taksave kërkon qeverisje të mirë.

Përfaqësues të shoqërisë civile, parlamentit, qeverisë, UNMIK-ut, institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare, ekspertë universiteti dhe mediat morën pjesë në tryezë.

"Forumi 2015" është koalicion i Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur - Soros dhe Riinvestit, dhe ka për qëllim të nxisë aktivitete të shoqërisë civile në Kosovë për integritet Euro-Atlantike.

**Letër e Hapur****OJQ Çohu Kërkon Llogaridhënie për Veturën e Re Luksoze të Ish-Krye Parlamentarit Nexhat Daci**

Ford Diplomat VIP

Organizata për demokraci, antikorrupsion dhe dinjitet, Çohu, ka kërkuar transparencë nga institucioni më i lartë legjislativ në vend lidhur me veturën luksoze të blerë nga Nexhat Daci.

Çohu ka bërë këtë kërkesë nëpërmjet një letre të hapur dërguar në janar Kryesisë së Parlamentit, Kryetarëve të Grupeve Parlamentare, dhe Kryesuesit të Komisionit për Kërkesa dhe Peticione Publike.

Letra është nënshkruar nga pesë OJQ tjera lokale: Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Asociacioni i Pensionistëve, Asociacioni i Gazetarëve Profesionist, Koalicioni "Gërmia 2005" dhe Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës.

Në letër thuhet:

*Mungesa e transparencës në blerjen e veturës "Ford Diplomat VIP 2005" nga Zyra e juaj me çmim tepër të lartë dhe joreal, në kohën kur varfëria në Kosovë po thellohet përditë e më tepër, ka ngritur dyshime për shkëlqimin ligji, keqpërdorim të parave publike dhe korrupsion. Për më tepër, pas akuzave publike në adresë të zyrës suaj, ju keni premtuar se do të jepni sqarim publik në lidhje me këtë.*

*Opinion publik dhe organizatat e nënshkruara në këtë letër, bazuar në ligjet e aprovuara nga Kuvendi i Kosovës, kërkojnë nga ju që, si një nga udhëheqësit më të lartë të Kosovës, të ofroni transparencën e premtuar për t'i hapur rrugë kështu zbatimit të një parimi elementar të demokracisë - llogaridhënies.*

*Dhënia e llogarisë në lidhje me blerjen e veturës me çmim aq të lartë, jo vetëm që do plotësojë këtë parim shumë të rëndësishëm të demokracisë, por do të jetë në interes edhe të qytetarit, si dhe të spastrimit të emrit të institucionit nga akuzat në lidhje me këtë rast.*

Për letrën e plotë ose më shumë informata, ju lutem kontaktoni: [organizatacohu@yahoo.com](mailto:organizatacohu@yahoo.com)

**Mundësi Financimi për OJQ-të****Kërkesë Propozimesh për Projekte të Rinjsh nga Evropa Juglindore**

Schüler Helfen Leben, organizatë bamirëse nga Gjermania, po kërkon propozime për t'u ndihmuar të rinjve të Evropës Juglindore.

Kjo organizatë përkrah projekte të të rinjve në Evropën Juglindore që kontribuojnë për pajtim dhe liri në rajon. Ajo ka dhënë donacione në vlerë mbi 13 milion euro për më shumë se 100 projekte në Kroaci, Bosnjë, Serbi, Maqedoni, Kosovë dhe Rumania.

Schüler Helfen Leben është iniciativë e pavarur, që ofron ndihmë të shpejtë dhe jo burokratike për t'u ndihmuar të rinjve nga vet të rinjtë.

Në vitin 2006, kjo organizatë është e interesuar të fi-

nancoj organizata joprofitabile, të cilat propozojnë t'i shpenzojnë donacionet për projekte në Evropën Juglindore.

Fituesit e granteve duhet të fokusohen në përkrahjen e drejtpërdrejt për fëmijët, të rinjtë dhe studentët e Evropës Juglindore: Kroaci, Bosnjë Hercegovinë, Serbi dhe Mal të Zi, Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, Bullgari, Rumania dhe Moldovë.

Projektet duhet t'u mundësojnë të rinjve qasje në shkollim, edukim dhe përkujdesje. Projektet po ashtu duhet:

a) Të jenë të hapura për të gjithë të rinjtë, pavarësisht nga gjinia, besimet, kombësia, gjendja ekonomike dhe përkatësia sociale, dhe

b) Ofron mundësitë dhe njohuritë e nevojshme për të rinjtë që të kenë mundësi të bëhen qytetarë me mendim-kritik e pjekuri të përgjegjshme të një shteti demokratik dhe t'u mundësohet të jenë financiarisht të pavarur.

Afati i fundit për aplikim është 15 marsi, 2006.

*Për më shumë informata lidhur me kriteret e seleksionimit, procedurat e seleksionimit, kushtet financiare, kohëzgjatja e përkrahjes, legjitimiteti i aplikantëve, e të tjera, ju lutem kontaktoni: +49 (0)30-30831692 ose vizitoni:*

[www.schueler-helfen-leben.de](http://www.schueler-helfen-leben.de)

**atrc**

**Drejtoreshë Ekzekutive**  
RREZE DULI  
rreze@advocacy-center.org

**Menaxher i Shërbimeve të  
Trajnimeve & Konsulencave**  
ILIR HOXHA  
ilir@advocacy-center.org

**Trajnere & Konsultante**  
MERITA BARILEVA  
merita@advocacy-center.org

**Trajnere & Konsultante**  
DONIKA SALIHU  
donika@advocacy-center.org

**Bashkëpunëtoreshë e  
Programit**  
NATYRA ZHJEQI  
natyra@advocacy-center.org

**Menaxher i Financave &  
Administratës**  
GANI ASLLANI  
gani@advocacy-center.org

**Menaxher për IT dhe  
Databasë**  
ARMEND SUSURI  
armend@advocacy-center.org

**Menaxhere për Komunikim  
& Ndërlidhje**  
ARJETA DOROCI  
arjeta@advocacy-center.org

**Rr. Agim Ramadani Nr. 15  
Kati i 2-të Prishtina, Kosova  
Phone/Fax: +381 (0) 38 244  
810**

## Zhvillime Ndërkombëtare të Shoqërisë Civile

### OJQ-të Startojnë Iniciativë Ambienti në Bosnjë

Hulumtuesit e Rinj nga Banja Lluca në bashkëpunim me Ekipin Ecco nga Sarajeva dhe Qendrën për Ambient dhe Energji nga Tuzla filluan në janar implementimin e projektit "Iniciativa për Ambient e Shoqërisë Civile në Nivel Lokal", përkrahur nga BE-ja.

Projekti ka për qëllim të arrijë bashkëpunim konkret ndërmjet shoqatave ambientaliste dhe qeverisjes lokale për çështje specifike të ambientit me rëndësi lokale.

Ai synon të krijojë ambient pozitiv për pjesëmarrje publike në proceset e planifikimit dhe vendim-marrjes në nivel lokal, përkrahje të sho-

qatave ambientaliste në aspektin e qasjes në informata, ngritjen e vetëdijes



*Rruga Ferhadija është rruga më e popullarizuar e këmbësorëve në Sarajevë*

publike dhe avokimin për edukim ambiental.

Me këtë iniciativë, OJQ-të planifikojnë implementimin e pesë pilot-projekte të vogla, me vlerë të përgjithshme prej €10,000.

Hulumtuesit e Rinj nga Banja Lluca dhe partnerët e tyre do të përkrahin përpjekjet e përbashkëta të shoqatave lokale dhe vetëqeverisjes lokale, e dizajnuar të mobilizojë resurset e brendshme dhe të identifikojë zgjidhje të qëndrueshme për mbrojtjen dhe përmirësimin e ambientit.

*Burimi: One World Southeast Europe*

### Një Kornizë e Përbashkët, Globale e Organizatave Joprofitabile

Shtimi mbarë botëror i organizatave joprofitabile u ka ofruar qytetarëve mundësi më të madhe në përmirësimin e kualitetit të jetës së tyre dhe në themelimin e rrjeteve paqësore ndërkufitare. Mirëpo, kornizat ligjore brenda të cilave këto organizata funksionojnë ndryshojnë ndër vende, sikurse edhe brenda atyre shteteve me sisteme federale ose të decentralizuara.

Ligjet mund të ndryshojnë në aspekte të tilla varësisht se çfarë janë kërkesat; kufizimet në pushtetet operative të organizatave; rregullat e raportimit, pushtetit, dhe format e riorganizimit; kërkesat për llogari-dhënie publike dhe transparencë; kufizimet në raport me përkrahjen publike dhe transaksionet financiare; masat e përcaktuara të kryerjes së detyrave; niveli i lejuar i pjesëmarrjes politike; përfitimet fiskale, siç janë përjashtimi nga taksat dhe mundësia

e marrjes së granteve qeveritare në dispozicion të disave ose të gjithave organizatave joprofitabile; dhe sfera e dënimeve formale dhe joformale të cilat mund t'ju caktohen organizatave, udhëheqësve të tyre, përkrahësve dhe anëtarëve.

A ekziston një pasqyrë e vetme konceptuale - ajo që operon pavarësisht nga misioni, kapaciteti dhe vendndodhja e organizatës - përmes së cilës OJQ-të mund të vështrohen, përpilojnë ligje shembullore, vlerësojnë punën e tyre, dhe kështu përfitojnë asistencë të përbashkët? Cila është platforma e përbashkët në të cilën e gjithë kjo mund të ndërtohet?

Aspekti i përbashkët i organizatave joprofitabile nuk është se të gjitha janë shoqata bamirëse, sepse disa nuk janë. Nuk është se ato nuk kanë motive përfitimi, një numër i tyre kanë, edhe pse në bazë të ligjit amerikan, ky

nuk mund të jetë motivi kryesor i ekzistencës së tyre. Në një nga artikujt e numrit të fundit të revistës së Qendrës Ndërkombëtare për Ligjin Jo-Profital, është argumentuar se veçoria e përbashkët e organizatave joprofitabile është (a) ato janë pasuri kapitale shoqërore, (b) ato ekzistojnë për t'i shërbyer publikut, (c) ato avancojnë qëllimet e tyre nëpërmjet politikave publike, dhe (d) qëllimi dhe funksionimi i tyre më së miri shihet nëpërmjet konceptit themelor të ligjit për punësim.

Kështu, secila organizatë joprofitabile mund të përshkruhet si pasuri kapitale sociale dhe agjent i publikut në marrëdhënien e strukturuar me publikun, të cilit i shërben. Për më shumë informata, ju lutem vizitoni:

[http://www.icnl.org/journal/vol8iss1/art\\_3.htm](http://www.icnl.org/journal/vol8iss1/art_3.htm)

*Burimi: Qendra Ndërkombëtare për Ligjin Jo-Profital*

Publikimi i këtij buletini mundësohet nga përkrahja zemërgjerë e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e ATRC-së dhe nuk reflekton detyrimisht qëndrimet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.